



Pranuar / Dorezuar Prijemljeno/Prodato Received/Delivered	31.07.2023	3	viti god year
Organ /Rjesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHUK	5467	/2023	116



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.850/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.850/2023 të datës 15.06.2023 të parashtruar nga ankuesja ^Ë Komunë të Prishtinës, kundër aktit me Nr. Ref: 180/2023 të datës 19.05.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje", në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të datës 31.07.2023,mori këtë:

V E N D I M

I.Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.850/2023 të datës 15.06.2023 të parashtruar nga ankuesja

II.Anulohet akti administrativ me Nr. Ref: 180/2023 i datës 19.05.2023 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje" ndaj ankueses.

III.Obligohet Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrin veprimet për shuarjen e masës disiplinore nga dosja personale e ankueses.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Më datë 15.05.2023 Zëvendësministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes emailit ka njoftuar Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme se *"ankuesja më datë 10.05.2023 pa aranzhim paraprak është paraqitur në zyrën time ka pasur sjellje të pahijshme në raport me asistenten time, sepse me çasje shumë agresive ka kërkuar llogari se si unë i përcaktoj anëtarët e delegacioneve të mijsa dhe ka kërkuar llogari se pse unë nuk i raportojsaj për rezultatet e udhëtimeve të mijsa zyrtare. Megjithëse asistentja i është zotuar se këto do të sqarohen kur unë të kthehem nga udhëtimi zyrtar, ajo ka eskaluar duke drejtuar ofendime banale ndaj Kryeministrit, Ministres G., Zëvendësministres G. dhe meje, dhe duke kërcënuar se do të ketë hakmarrje për vendimet e kësaj Qeverie, kur Republika e Kosovës do të ketë një Qeveri tjetër në të ardhmen"*.

Më datë 19.05.2023 Zyra e Sekretarit të MPJD, përmes emailit të dërguar për ankuesen ka ftuar të njëjtën në takim me Sekretarin e Përgjithshëm në orën 14:00. Pas kësaj Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes aktit me Nr. Ref: 180/2023 të datës 19.05.2023, ankueses e cila është e punësuar në pozitën *"Zyrtare e Lartë për Organizatat Ndërkombëtare"* i ka shqiptuar masën disiplinore *"Vërejtje"*.

Ankuesja, kundër masës disiplinore *"Vërejtje"* të datës 19.05.2023, më datë 15.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4751/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijs së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa Këshilli më datë 21.06.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijs e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4751/2023 të datës 15.06.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktin me Nr. Ref: 180/2023 e datës 19.05.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për shqiptimin e masës disiplinore Vërejtje ndaj ankueses; Emaili i datës 19.05.2023 nga Zyra e Sekretarit MPJD për ankuesen; Kërkesën për takim e datës 29.05.2023, 22.05.2023, 05.06.2023 nga ankuesja për B.I; Kërkesë e datës 12.06.2023 nga ankuesja për B.I; Emailin e datës 22.03.2023 nga B.I për ankuesen; Emailin e datës 14.03.2023 nga ankuesja për B.I; Emailin e datës 20.03.2023 nga A.H-E; Emailin e datës 14.03.2023 nga ankuesja për B.I; Emailin e datës 10.02.2023 nga Zyra e Sekretarit MPJD për ankuesen dhe të tjerët; Emailin e datës 09.02.2023, 08.02.2023 nga ankuesja për I.H; Emailin e datës 09.02.2023 nga I.H për ankuesen; Emailin e datës 01.02.2023 nga ankuesja për Zyrën e Sekretarit MPJD; Emailin e datës 01.02.2023 nga Zyra e Sekretarit MPJD për ankuesen; Akt Emërimin AE.Nr. 55/2023 të datës

13.06.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 19.06.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 21.06.2023; Emailin e datës 15.05.2023 nga K.A për B.I; Vendimin me Nr. Ref: 63/2021 të datës 08.03.2021; Emailin e datës 19.06.2023 nga V.B për A.B.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës përkatësisht provave të administruara, konstaton se ankesa e ankueses, është e bazuar, sepse:

Në funksion të shqyrtimit të ligjshmërisë së masës disiplinore të kundërshtuar me ankesë, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë referuar procedurës disiplinore të nëpunësve civilë përkatësisht nenit 45 më të cilin përcaktohet se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se nëpunësi civil mbanë përgjegjësi disiplinore në rastet kur vërtetohet se i njëjti me veprimet ose mosveprimet e tij ka shkelur dispozitat e ligjit në fuqi ndërlidhur me detyrat funksionale dhe përgjegjësitë e punës për pozitën që mbanë, dhe mbi bazën që të jenë plotësuar në mënyrë komulative elementet e përgjegjësisë disiplinore, rrjedhimisht organet kompetente në zbatim të autoritetit publik me rastin e vendosjes lidhur me të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të nëpunësve civil janë të obliguar që të veprojnë në pajtueshmëri me parimin e ligjshmërisë,proporcionalitetit,barazisë, mosdiskriminimit, objektivitetit, paanësisë, pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme, si dhe parimin e informimit dhe ndihmës aktive siç është përcaktuar me nenin 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, dhe 11 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative,por se në rastin konkretë sa i përket objektit të kësaj ankesë kemi devijim nga obligimi për të vepruar në harmoni me këto parime ligjore.

Po ashtu, Kolegji në lidhje me këtë çështje që është objekt i kësaj ankesë përkatësisht me rastin e vendimmarrjes mori parasysh edhe dispozitat e nenit 46 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilat dispozita janë përcaktuar në mënyrë shprehimore shkeljet disiplinore, ku parashihet se: *Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta.... 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar".*

Rrjedhimisht, në kuptim të bazës ligjore si më sipër si dhe bazuar në vlerësimin e provave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se masa disiplinore *"Vërejtje"* e datës 19.05.2023 është shqiptuar ndaj ankueses mbi bazën se e njëjta me datë 10.05.2023 ka pasur sjellje kundër kodit të etikës në zyrën e Zëvendësministrit të Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës, duke u cilësuar si shkelje e lehtë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.2, 4.3 dhe 4.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe e njëjta është shqiptuar vetëm mbi bazën e njoftimit nga Zëvendësministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, por nuk janë marrë për bazë edhe rrethanat e tjera që mund të kishin pasur ndikim në këtë çështje sa i përket shqiptimit

të kësaj mase disiplinore, ngase edhe pse Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka pasur takim me ankuesen më datë 19.05.2023, nuk ka ndonjë dëshmi konkrete në shkresat e lëndës se çka është biseduar në atë takim, rrjedhimisht nuk mund të vërtetohet fakti se provat mbi bazë të të cilave i është shqiptuar masa disiplinore ankueses, a janë prova të besueshme për shkak që nuk mund të vendoset vetëm mbi bazën e një njoftimi pa u vërtetuar në mënyrë të drejtë qoftë edhe përmes dëshmitarëve të tjerë eventual, së paku në arsyetim të shqiptimit të masës disiplinore nuk është paraqitur ndonjë argumentim faktik i qëndrueshëm përmes së cilave fakte vërtetohet padyshim se e njëjta ka kryer ndonjë veprim që bie ndeshë me legjislacionin e shërbimit civil, duke pasur parasysh rrethanën se ndaj ankueses është shqiptuar masa disiplinore mbi bazë të deklaramëve të zyrtarëve të tjerë dhe se eprori në këtë rast Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm me rastin e shqiptimit të masës disiplinore përveç që në arsyetim të "Vërejtjes" është bazuar në një raportim nga Zëvendësministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes shkresës/emailit të datës 15.05.2023, i cili ka njoftuar eprorin e ankueses përkatësisht Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm se ankuesja më datë 10.05.2023, kishte shkaktuar një incident në zyrën e tij me që rast kishte pasur sjellje të papranueshme në raport me asistenten e Zëvendësministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në ndërlidhje me këtë situatë të raportimit me asnjë provë nuk është arrit të konfirmohet se deklaramet e asistentes kanë qenë të argumentuara me ndonjë provë konkrete relevante dhe duke pasur parasysh edhe rrethanën se as eprori që i ka shqiptuar vërejtjen e as inicuesi përkatësisht Zëvendësministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës nuk kanë qenë të ndërlidhur direkt me rastin nga se nuk kanë qenë të përfshirë në këtë situatë përveç me njoftimin që është bërë nga zyrtarja e zyrës së Zëvendësministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmbajtja e deklarametës e së cilës ishte elaboruar në shkresën e datës 15.05.2023, andaj është obligim ligjorë material që me rastin e trajtimit të zyrtarëve publik në çështje të ndryshme administrative që të veprohet konform Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 7 paragrafi 1 në të cilin parashihet: "Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë", bazuar në këto dispozita shqiptimi i masës disiplinore që është objekt i kësaj ankese bie ndeshë me përmbajtjen e kësaj dispozite e që e bënë të qëndrueshëm pretendimin ankimor të ankueses në këtë kuptim të shkeljes së dispozitave materiale.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave bazuar në at që u tha si më lartë përkatësisht bazës ligjore të marrë për bazë me rastin e vendimmarrjes, kishte parasysh edhe faktin se përveç që inicuesi i procedurës së shqiptimit të masës disiplinore poashtu edhe eprori që i kishte shqiptuar "Vërejtjen" ankueses nuk kishin qenë palë të përfshira direkt në rast në kohën kur ishte raportuar se kishte ndodhë incidenti ashtu si u tha më lartë, nuk kishin arrit të argumentojnë me ndonjë provë konkrete që raportimi në lidhje me shkeljen e kodit të etikës nga ankuesja ishte i qëndrueshëm respektivisht i argumentuar me fakte konkrete, andaj edhe kolegji me rastin e vendimmarrjes nuk mundi të i japë besimin deklaramet të asistentes nga zyra e Zëvendësministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës i cili deklaramet ishte shndërruar pastaj në

konstatim nga vetë Zëvendësministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me rastin e raportimit se ankuesja kishte pasur sjellje të papranueshme dhe në kundërshtim me kodin e etikës, poashtu ishte me rendësi edhe rrethana se ndaj ankueses përkatësisht nga shkresat e lëndës nuk ishte vërtetuar se kishte pasur më herët ndonjë masë disiplinore të shqiptuar ndaj saj, e poashtu edhe nga shkresa inicuese e raportimit të incidentit nuk ishte konkretizuar ndonjë veprim që cenon ndonjë dispozitë konkrete të ligjit të zyrtarëve publik, për më tepër e njëjta/ankuesja kishte pasur disa iniciativa për takim me eprorin me qëllim që të diskutohen çështje që ndërlidhen me këtë masë disiplinore dhe çështje tjera që ndërlidhen me fushëveprimin e përgjegjësiive të ankueses, por se me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Vërejtjes" nuk ishin marrë për bazë, andaj ky veprim bie ndeshë me dispozitat e ligjit Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenin 92 paragrafi 1 ku parashihet: "E drejta e njohjes me dosjen dhe marrjes së informacionit 1. Pala, në çdo fazë të procedurës, ka të drejtë të njihet me dokumentet e dosjes së procedurës administrative dhe të marrë kopje të dokumenteve që gjenden në të", nenin 94: "E drejta për të paraqitur mendime, shpjegime dhe prova Pala, në çdo fazë të procedurës, ka të drejtë të paraqesë mendime, shpjegime për faktet, rrethanat apo edhe çështjet ligjore, që kanë të bëjnë me procedurën përkatëse, së bashku me provat e dokumentet përkatëse, në të cilat i mbështet ato si dhe të paraqesë propozime për zgjidhjen e çështjes".

Kolegji i Këshillit duke pasur parasysh se ishin edhe disa pretendime tjera që ndërlidhen me rastin konkretë por se nuk u lëshue më tutje në pretendimet tjera nga se nuk kishin ndonjë relevante sa i përket vendimmarrjes andaj konstaton se për shkak të këtyre rrethanave akti i kontestuar me këtë ankesë, është nxjerr si rezultat edhe i shkeljeve procedurale, ngase akti që është kontestuar me ankesë është i paligjshëm në kuptim të nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që në kuptim të dispozitivit dhe arsytimit të këtij vendimi, Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, janë të obliguar që në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi të bëjë shuarjen e masës disiplinore nga dosja personale e ankueses.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.850/2023, datë 31/07/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses,
- Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.